

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 19 prill 2023 nga Sh.S., avokat nga Lipjani. me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtarja r Gjykatës Themelore në Ferizaj L.P., në bazë të nenit 3, 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 27 prill 2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e datës 19 prill 2023 parashtruar nga Sh.S., avokat nga Lipjani, kundër L.P., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me pretendimin për shkelje disiplinore në çështjen civile të evidentuar në gjykatë si: C.nr.1572/20 (nr.smil. 2020:131784), për shkak se nuk konstatohet se kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj si autoritet kompetent, më 19 prill 2023 përmes zyrës së pranimit në gjykatë, ka pranuar ankesën disiplinore të arashtruar nga Sh.S., avokat nga Lipjani, ankesë kjo e paraqitur kundër gjyqtares së Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, L.P., me pretendimin për shkelje disiplinore.

Parashtruesi i ankesës avokat Sh.S. në ankesë e parashtruar ka theksuar se në këtë gjykatë është duke u udhëhequr procedurë kontestimore lidhur me pagesën e borxhit ku si i paditur ka qështë klienti i tij K.F. dhe se në seancën e datës 11.05.2022 kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtares së kësaj çështje dhe për koinçidencë e njëjta nuk ka vepruar konform detyrimit ligjor në rastet kur paraqitet kërkesa për përjashtim gjatë procedurës gjyqësore, mirëpo pavarësisht se nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore që ta ndërpresë çështjen kontestimore dhe ta obligoj palën e paditur që në afat prej 3 ditësh të paraqes kërkesë me shkrim me arsyetimin e propozimit për përjashtim.

I padituri me datë 13.05.2022 përmes postës me rekomandë R.22... ka ushtruar kërkesë për përjashtimin e gjyqtares e të cilën kërkesë e kemi adresuar për kryetarin e gjykatës.

Ndërsa me datë 24.01.2023 me parashtresë të veçantë kemi kërkuar shtyrjen e seancës të caktuar për datën 25.01.2023 me arsyetimin se meqenëse nuk jemi njoftuar me kërkesën tonë për përjashtimin e gjyqtares, kemi kërkuar shtyrjen e seancës dhe të njëjtën kohë kemi kërkuar që gjyqtarja të na informoj lidhur me kërkesën tonë pasi deri në pranimin e ftesës për seancë nuk kanë pas informoacione se si është vendosur apo a është vendosur lidhur me kërkesën për përjashtim, mirëpo edhe për kundër parashtresës për shtyrjen e seancës me arsyetimet si më lartë, gjyqtarja me datë 25.01.2023 ka mbajtur seancën në mungesë tonë.

Në vazhdim në arsyetimin e ankesës disiplinore, ankuesi ka theksuar se gjyqtarja ka bërë shkelje disiplinore pasi ka mbajtur seancë pa u vendosur fare lidhur me kërkesën e tij për përjashtim, e mbi të gjitha në aktgjykimin 2021:131784 të datës 25.01.2023 ajo në arsyetimin e sajë askund nuk përmend se i autorizuari i të paditurit të parë ka parashtruar kërkesë me shkrim për përjashtimin e sajë, si është vendosur lidhur me këtë kërkesë e mbi të gjitha askund nuk përmend parashtresën tonë të datës 24.01.2023 me të cilën kemi kërkuar shtyrjen e seancës. Nëse i referohemi aktgjykimin të atakuar lidhur me kërkesën për përjashtim, gjyqtarja e shkallës së parë e përmendur vetëm një fakt se me datë 11.05.2022 avokati Sh.S. ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit dhe seanca e radhës është mbajtur me datë 25.01.2023 në mungesë të të paditurit, për çka e kemi të paqartë se gjyqtarja e denoncuar ose nuk ka njohuri profesionale ose këto veprime i ka kryer qëllimisht pasi që në momentin kur kemi kërkuar përjashtimin e sajë, kemi vërejtur jokredibilitet, kemi vërejtur jo objektivitet pasi që çdo propozim tonin në drejtim të mbrojtjes në raport me kërkesë padinë e paditësit kjo gjyqtare e ka refuzuar, dhe qëndrimin tonë se kemi të bëjmë me një gjyqtare jokredibile dhe jo objektive po e vërteton edhe ky fakt ku kjo gjyqtare edhe pse në seancë drejt për drejtë i kërkohet përjashtimi i sajë, nuk vepron sipas udhëzimeve ligjore, i paraqitet kërkesa me shkrim për përjashtimin e sajë, sigurisht nuk e ka dërguar tek kryetari i gjykatës për të vendosur lidhur me përjashtimin e sajë, cakton seancë gjyqësore pa më kthyer përgjigje lidhur me kërkesat e mija, e mbi të gjitha mbanë seancë në mungesë tonë, ndërsa posedon parashtresën për shtyrjen e seancës të datës 14.01.2023.

Pra nga të gjitha këto veprime, gjyqtarja ka treguar arbitraritet të pajustificueshëm e mbi të gjitha ka vendosur për një kërkesëpadi që pa dashur të lëshohem në atë pjesë pasi që ne kemi atakuar me ankesë në procedurë të rregullt, por kjo mënyrë e zhvillimit të procedurës për ne është e pajustificueshme, e mbi të gjitha konsiderojmë se në veprimet e të njëjtës kemi shkelje disiplinore. Për ëka ka propozuar që ankesën disiplinore ta orientoj në procedurë disiplinore dhe ndaj të njëjtës të fillohet dhe zhvillohet procedurë disiplinore dhe pas përndimit të procedurës të shpallet përgjegjëse për shkelje disiplinore.

Kryetari i Gjykatës, si autoritet kompetent pas pranimit të ankesës duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057 përmes shkesës ADGJTHFR.nr.6/23 të datës 19 prill 2023 ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës lidhur me regjistrimin e ankesës së parashtruar nga Sh.S., avokat nga Lipjani.

Duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës si autoriteti kompetentë po me datë 20 prill 2023 ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja ndaj të cilit është parashtruar ankesa, deklaratë të cilën më pas gjyqtarja në formë të shkruar e ka bërë me datë 24 prill 2023 e përmes të cilës ka deklaruar se me rastin e kësaj ankese njoftoj kryetarin e gjykatës se avokati i cili ka parashtruar këtë ankesë kur është paraqitur për herë të parë në seancën e tretë ka qenë totalisht i papërgatitur dhe i pa informuar, dhe kur të njëjtit i është shpjeguar se gjykata ka lejuar që të mbahet edhe një seancë edhe pse procedura e provave kishte përfunduar, i padituri ka theksuar se ka provë të besueshme dhe për këtë gjykata të njëjtit ia ka dhënë rastin që ta sjellë atë provë në seancën e radhës. Në seancën e radhës avokati Sh.S. paraqitet për herë të parë, ka qenë i pa përgatitur dhe i panjoftuar për rastin, i jep të drejtë vetes që ta ofendoj atë si gjyqtare për jo objektivitet dhe jo profesionalizëm e gjithashtu edhe përkthyesit dhe ka thënë se do të ankohet te kryetari i gjykatës, çka edhe i është lejuar.

Me datë 11.05.2022 ka parashtruar kërkesë për përjashtimin tim dhe pas kësaj si gjyqtare ka dhënë edhe deklaratën e sajë lidhur me këtë kërkesë për përjashtim dhe atë me dtë 06.06.2022, ndërsa kryetari i gjykatës kërkesën për përjashtim e ka refuzuar si të pabazuar, për këtë më pas me datë 25.01.2023 kam caktuar seancën e radhës dhe u kam dërguar ftesa palëve ku avokati i

palës së paditur ftesën e ka pranuar me datë 18.01.2023 mirëpo në seancë nuk është paraqitur, për çka gjykata ka mbajtur seancën e caktuar për datën 25.01.2023 në mungesë të të paditurit sepse këtë ia mundëson ligji dhe ka marrë aktgjykimin i cili është ngarkuar në SMIL me datë 20.02.2023.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarës së rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese por edhe shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarës L.P.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit K.F., avokat Sh.S. nga Lipjani të datës 11.05.2022 e dorëzuar në gjykatë përmes postës ku dhe është pranuar me datë 18.05.2022, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës L.P.

Me aktvendimin C.nr.1572/20 (nr.smil 2020:131784) të datës 20 qershor 2022 Kryetari i Gjykatës ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga i autorizuari i të paditurit për përjashtimin e gjyqtarës dhe shkresat e lëndës ia ka kthyer gjyqtarës së njëjtë për trajtimin e kësaj çështje.

Sipas vlerësimit të Autoritetit kompetent theksimet e palës ankuese se i njëjti nuk është njoftuar lidhur me kërkesën e tij për përjashtim, është i pabazuar, pasi që Kryetari i Gjykatës me aktvendimin C.nr.1572/20 (nr.smil 2020:131784) të datës 20 qershor 2022, ka refuzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës nga trajtimi i kësaj çështje kontestimore dhe shkresat e lëndës ia ka kthyer gjyqtarës së çështjes për trajtim dhe gjyqtarja e njëjtë seancën gjyqësore e ka caktuar për shqyrtim me datë 25.01.2023, ku edhe i ka dërguar ftesa për shqyrtim gjyqësor të gjitha palëve, dhe se po të ishte përjashtuar kjo gjyqtare nga ana e kryetarit të gjykatës e njëjta nuk do të mund të caktonte shqyrtim gjyqësor në këtë çështje, dhe nuk do ti dërgonte ftesa palëve për shqyrtim gjyqësor, mirëpo gjyqtarja duke vepruar sipas Aktvendimit mbi refuzimin e përjashtimit të saj si gjyqtare për ta gjykuar këtë çështje edhe e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim gjyqësor sigurisht që edhe palët do të njoftoheshin edhe lidhur me këtë vendim të kryetarit të gjykatës, ndaj të cilit vendim për përjashtim të gjyqtarit konform nenit 70 pika 5 e LPK-së nuk lejohet ankesë e veçantë, por i njëjti mund të ankimohet me mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar, gjë që edhe përfaqësuesi i palës së paditur, av.Sh.S., Aktgjykimin e kësaj gjykate

C.nr.1572/20 -2021:131784 i datës 25.01.2023, e ka ankimuar ku edhe ka paraqitur edhe pretendimet e tija ankimore sa i përket kërkesës së tij për përjashtimin e gjyqtares.

Andaj edhe pretendimi se gjyqtarja ka mbajtur seancë pa u vendosur fare lidhur me kërkesën për përjashtim, dhe se aktgjykimi C.nr.2021:131784 i datës 25.01.2023, në arsyetimin e saj askund nuk përmend se si është vendosur lidhur me kërkesën për përjashtim dhe se seanca e datës 25.01.2023 është mbajtur në mungesë të paditurve, është jo i bazuar, pasi që autoriteti kompetent vlerëson se për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjyqtarit gjatë punës së tij, mund të jenë shkak apo arsye për ushtrimin e mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga pala e pakënaqur, por nuk mund të konsiderohen shkelje disiplinore.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.6/23

27 prill 2023

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Sh.S., avokat nga Lipjani, Parashtrues i ankesës

L.P., Gjyqtare

Këshillit Gjyqësor të Kosovës